



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Prof. Dr. Bajram Kosumi
Rektor

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar rektorë universitetesh, hulumtues
shkencorë, pedagogë, drejtues të tjerë,
Zonja dhe zotërinj,
Në emrin tim personal, në emër të drejtuesve të
tjerë të UKZ, të stafit akademik dhe administrative
dhe në emër të studentëve ju dëshiroj mirëseardhje
në Gjilan, në Univerrsitetin Kadri Zeka, në
Konferencën Ndërkombëtare "Roli I teknologjisë në
formësimin e shoqërisë".

Ka gjasa që teknologjia digjitale është shpikja më e
madhe në historinë e njerëzimit. Ajo sot është
promotori dhe gjeneratori kryesor i zhvillimit
ekonomik. Fabrikat e shekujve XIX-XX sot është
kompjuteri.

Digjitalizimi i dijeve, i përvojës dhe inteligjencies
njerëzore është hap i madh drejt njeriut të shumë
dijshtëm.

Disa popuj e disa kultura kanë ecur përpara në këtë
drejtim. Në Kosovë dhe në kulturën shqiptare ka një

ngecje, dhe kjo ngecje është paradoks më vete. Statistikat tregojnë se përqindja e kosovarëve që kanë qasje në internet është ndër më të lartat në Europë-ndërsa në anën tjetër digjitalizimi i proceseve kulturore, ekonomike dhe inxhinierike është një hap prapa. Ndërsa, vërtetë sa për krahasim, po përmend Fransoa Lotardin, i cili qysh në vitin 1982 alarmonte kulturën dhe politikën francezë për ndryshimin e statusit të dijes në shoqëri dhe për nevojën e ngutshme të digjitalizimit, për të përballuar proceset e globalizmit.

Pse ndodh ky paradoks nuk ka një përgjigje. Por, ka gjasa që një ndërlidhje më e mirë e procesit akademik-inxhinierik dhe biznesor ta ndryshojë këtë paradoks.

Ndërkommunikimi shkencor sot është bërë më i rëndësishëm se asnjëherë deri tash. Proceset e globalizmit, të cilat në masën më të madhe mbështeten në mundësitë që krijon teknologjia digjitale, e bëjnë të domosdoshëm komunikimin e të arriturave tona shkencore.

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të ju dëshiroj sukses në këtë konferencë, që të prezantoni të arriturat e juaja shkencore dhe të diskutoni në fund të çdo sesioni për këtë të arritura. Urime!

Gjilan, 11.11.2022